



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

MEMORANDUM SHPJEGUES: Për Draft-Statutin e Teatrit "Adriana Abdullahu"

1. Qëllimi i Draft-Statutit

Ky Draft-Statut është hartuar me qëllim të rregullimit të organizimit, funksionimit, menaxhimit dhe veprimtarisë së Teatrit "Adriana Abdullahu", në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës dhe kompetencat e Komunës së Ferizajt në fushën e kulturës.

Statuti përcakton misionin, kompetencat, strukturën organizative, organet drejtuese, përgjegjësitë e tyre, mënyrën e menaxhimit administrativ dhe financiar, si dhe të drejtat dhe detyrimet që lidhen me funksionimin e institucionit.

2. Baza ligjore

Draft-Statuti është hartuar duke u mbështetur në: Duke u bazuar në dispozitat e nenit 10 (pikat 2 dhe 3), si dhe nga pika 3.1 deri në pikën 3.8, nenit 20 (pika 1.9) të Ligjit Nr. 08/L-245 për Art dhe Kulturë; nenit 10 (pika 2.4) dhe nenit 12 (pika 12.2) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; neneve 5, 6 (pika 1.2), nenit 7 (pikat 2 dhe 3), nenit 16 (pikat 1, 2 dhe 3) dhe nenit 5, paragrafi 1, pika 1.3, paragrafit 4, neneve 89, 90 dhe 91 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë; si dhe nenit 10 (pika 2.4) të Statutit të Komunës së Ferizajt (01 nr. 50, i datës 28.06.2013)

3. Arsyetimi i miratimit



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT

KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA

MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002

E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Miratimi i Statutit është i nevojshëm për krijimin e një baze të qartë juridike dhe organizative për funksionimin e Teatrit "Adriana Abdullahu". Përmes këtij statuti përcaktohen procedurat e menaxhimit institucional, përgjegjësitë e organeve drejtuese, mënyra e zhvillimit të veprimtarisë artistike dhe administrative, si dhe mekanizmat e transparencës dhe llogaridhënies.

Statuti gjithashtu krijon parakushtet për zhvillimin e qëndrueshëm të teatrit, promovimin e krijimtarisë artistike, bashkëpunimin me institucione të tjera kulturore brenda dhe jashtë vendit, si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët.

4. Përfundimi

Duke pasur parasysh rëndësinë e funksionimit të rregullt institucional të Teatrit "Adriana Abdullahu", propozohet që Draft-Statuti të shqyrtohet dhe të miratohet nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt, me qëllim të krijimit të një kornize të plotë ligjore dhe organizative për zhvillimin e veprimtarisë së tij artistike dhe kulturore në shërbim të qytetarëve.